


**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Shkurt, 2022**

SBASHK vazhdon me takimet konsultative

Kundërshtime ndaj Draft Ligjit të pagave, përgatitje për veprime sindikale



Situata në sektorin e arsimit po përcillet me mjaft sfida. Ato u shtuan me daljen në publik të një versioni të Draft ligjit të pagave. Ky version krijoi pakënaqësi të arsyeshme sepse është degradues për tërë sistemin e arsimit dhe të kulturës. Kjo bëri që SBASHK të shtojë komunikimin dhe takimet konsultative me anëtarësinë, Këshillin Drejtues dhe me kryetarët e nivelit komunal e të Universiteteve. Kështu ishte edhe të dielën e 13 shkurtit, por edhe në ditët në vazhdim. Temë kyçe e debatit në këtë ... (faqe 4)

Vazhdojnë edhe në muajin shkurt aktivitetet në shërbim të anëtarësisë

Mirënjohje dhe respekt meritore për SBASHK-un

SBASHK edhe të shtunën e të dielën e 5 dhe 6 ... (faqe 5)

Marrëveshje me Ordinancën Stomatologjike 'MORFODENT'

Shërbimet mjekësore 33 % më lirë për anëtarët e SBASHK-ut

Nga angazhimet e veçanta të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë është edhe nënshkrimi i marrëveshjeve me bizneset ... (faqe 6)

Flasin kryetarët e komisioneve

Po bëhen përgatitje me kohë për Kongresin zgjedhor të SBASHK-ut

Pasi që viti zgjedhor në SBASHK është përmbyllur me sukses kanë nisur me kohë përgatitjet për mbajtjen e Kongresit zgjedhor. Këshilli Drejtues bashkë me stafin qendror dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve... (faqe 3)

Vazhdojnë takimet e SBASHK-ut me MASHTI-n

Temë e bisedës Ligji i pagave dhe çështje të tjera

Përfaqësuesit e SBASHK-ut vazhdojnë me angazhimet me qëllim që kërkesat legjitime të anëtarësisë të gjejnë zgjidhje meritorë me... (faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Po vjen marsi i datave të mëdha



Marsi sa herë vjen rikthen kujtesën për ngjarjet e datat që kanë hyrë në faqet e ndritura të historisë sonë kombëtare. Një kujtesë e bartur dhe e ruajtur ndër dekada e shekuj është dita e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe. Sa herë vjen marsi mësuesit e nxënësit lartësojnë kujtimin për pishtarët e dijes që nëpër dekada e shekuj mbrojtën rrezet e dritës kundër errësirës. Ata kujtojnë e lartësojnë kujtimin edhe për Epopenë e lavdishme të UÇK-së dhe për komandantin legjendar Adem Jashari, që i ndërruan kahen historisë dhe u bën gurthemel të lirisë së Kosovës.

SBASHK edhe në këtë mars do të lartësoj kujtimin për pishtarët e dijes duke organizuar aktivitete përkujtuese e duke ndarë mirënjohje për koleget e kolegët tanë që u pensionuan nga marsi vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti. Situata me pandeminë dhe kufizimet që kanë bërë institucionet në parandalimin e pamundësuan organizimin e Manifestimit madhështor që organizonte SBASHK Pallatin e sporteve “1 Tetori” në Prishtinë, por aktivitete e atmosferë feste do të ketë në çdo shkollë dhe mësuesit e nxënësit edhe në fillimet e këtij marsi do të lartësojnë kujtimin për pishtarët e dijes që nëpër dekada e shekuj mbrojtën rrezet e dritës kundër errësirës.

Bashkë në SBASHK gjithmonë do ta lartësojmë kujtimin për pishtarët e dijes.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Flasin kryetarët e komisioneve

Po bëhen përgatitje me kohë për Kongresin zgjedhor të SBASHK-ut

Pasi që viti zgjedhor në SBASHK është përmbyllur me sukses kanë nisur me kohë përgatitjet për mbajtjen e Kongresit zgjedhor. Këshilli Drejtues bashkë me stafin qendror dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve e duke respektuar edhe vullnetin e miqve ndërkombëtarë për të marrë pjesë në këtë ngjarje të veçantë kanë sjellë vendim që Kongresi të mbahet më 2 prill. Angazhimi i parë ishte caktimi i vendit të mbajtjes së Kongresit dhe SBASHK falënderon dekanin dhe stafin e Fakultetit të edukimit për gatishmërinë që Kongresi të mbahet në ambientet e këtij institucioni të arsimit të lartë. Këshilli Drejtues ka emëruar edhe komisionet gjegjëse, që krahason Komisionit statutar, me kohë kanë nisur angazhimet konkrete. Kryetarët e këtyre Komisioneve flasin për “Arsimimi sot”.



Ymer Ymeri, kryetar i Komisionit Statutar

Me qëllim që t’u japim mundësi gjithë anëtarësisë që të jep kontribut në ndryshimet, që mendojnë se duhet bërë, kemi publikuar me kohë apelin

që brenda afatit të përcaktuar anëtarët e anëtarët e SBASHK-ut përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve të dërgojnë propozime konkrete, të cilat do të analizohen e shqyrtohen me kujdes nga Komisioni. Propozimet e arritura, por edhe propozime konkrete nga anëtarët e Komisionit do të analizohen me kujdes dhe do t’i prezantohen delegatëve të Kongresit më 2 prill dhe pastaj propozimet e miratuara do të zënë vend në Statutin e SBASHK-ut.



Vjollca Shala, kryetare e Komisionit Përgatitor

Me kohë kemi nisur përgatitjet. Anëtarët e këtij Komisioni janë emëruar nga Këshilli Drejtues dhe presim angazhimin e vazhdueshëm të secilit prej tyre sepse përgatitjet duhen bërë me

kohë. Falënderojmë Fakultetin e edukimit për mirëkuptimin dhe ndjehemi mirë që kjo ngjarje e veçantë do të zhvillohet në ambientet e këtij institucioni të arsimit të lartë. Jemi duke vazhduar me angazhimet dhe takimet. Në mbështetje të stafit qendror po angazhohemi edhe në përzgjedhjen dhe përgatitjen e materialeve për Kongresin dhe për gjithë çështjet tjera konkrete me qëllim që kjo ngjarje shumë e rëndësishme të ketë rrjedhë të mbarë. Bazuar në zellin dhe përkushtimin, delegatët dhe mysafirët e nderuar ndërkombëtarë e vendor do të kthehen nga Kongresi me përshtypje të shkëlqyera.



Veli Morina nga Komisioni për kandidim

Këshilli Drejtues na ka nderuar duke na besuar një detyrë të rëndësishme dhe ne do ta kryejmë me përkushtim e sukses. Do të pranojmë kandidimet dhe

do ta analizojmë me kujdes çdo propozim të ardhur duke respektuar në tërësi Statutin. Ajo që dihet deri tani është se shumë nga komunat kanë kandiduar edhe për një mandat kryetarin e tanishëm Rrahman Jasharaj duke treguar kështu respektin meritore për përkushtimin e tij. Presim edhe kandidime të tjera, të cilat do i prezantojmë para delegatëve dhe pastaj ata do të vendosin me votën e lirë se kush do të jetë kryetar i SBASHK-ut në mandatin e radhës.



Vlora Rexhepi Berisha, zyrtare në SBASHK

Detyrë e imja konkrete lidhur me përgatitjen e Kongresit është dërgimi i ftesave dhe komunikimi me mysafirët vendor e ndërkombëtar lidhur

me pjesëmarrjen e tyre në Kongres. Ndjehemi krenar sepse shumë emra të çmuar të sindikalizmit nga Evropa dhe e tërë bota kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe kjo ia shton madhështinë kësaj ngjarje të veçantë për sindikatën tonë.


Gjatë muajit

SBASHK vazhdon me takimet konsultative

Kundërshtime ndaj Draft Ligjit të pagave, përgatitje për veprime sindikale

Situata në sektorin e arsimit po përcillet me mjaft sfida. Ato u shtuan me daljen në publik të një versioni të Draft ligjit të pagave. Ky version krijoi pakënaqësi të arsyeshme sepse është degradues për tërë sistemin e arsimit dhe të kulturës. Kjo bëri që SBASHK të shtojë komunikimin dhe takimet konsultative me anëtarësinë, Këshillin Drejtues dhe me kryetarët e nivelit komunal e të Universiteteve. Kështu ishte edhe të dielën e 13 shkurtit, por edhe në ditët në vazhdim. Temë kyçe e debatit në këtë takim dhe në konsultimet e vazhdueshme ishte versioni që po qarkullon i Draftit të Ligjit të ri të pagave e veçmas shtojcat e koeficienteve.

Përfaqësuesit e të punësuarve në arsim, që nga çerdhet e deri në Universitete, pasi kanë bërë vërejtje konkrete, kanë shprehur kundërshtime të bazuara ndaj këtij versioni të Draft Ligjit të pagave. Për SBASHK-un është i papranueshëm raporti i koeficienteve 1 me 20, që favorizon shumë qeveritarët në dëm të të punësuarve në arsim, kulturë por edhe sektorë të tjerë, e po ashtu është e papranueshme edhe tendenca për zbritje të koeficienteve për numrin më të madh të të punësuarve në arsim.



Pjesëmarrësit e këtij takimi të jashtëzakonshëm pas një debati të gjatë e konstruktiv kanë autorizuar Kryesinë dhe komisionin e ekspertëve të fushës që të vazhdojnë me angazhimet dhe t'ia prezantojnë Ministres Nagavci dhe Ministrit Sfeçla propozimet

konkrete e të argumentuara të SBASHK-ut me qëllim që të punësuarit në tërë sektorin e arsimit dhe në atë të kulturës të kenë vend meritore në Ligjin e ri të Pagave, e jo pozitë nënçmuese e të degraduar, siç është tani në versionin që po qarkullon, të Draft Ligjit të Pagave.

Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve kanë marrë vendim unanim se nëse MASHTI dhe Ministria që drejton Ministri Sfeçla i ikin takimeve me përfaqësuesit e SBASHK-ut, apo nuk përfillojnë kërkesat e argumentuara të punëtorëve të tërë sektorit të arsimit e të kulturës, atëherë në pjesën e parë të marsit do të ketë veprime sindikale paralajmëruese, gjegjësisht protesta me numër të kufizuar pjesëmarrësish dhe nëse edhe pas kësaj nuk do të ketë ndryshime pozitive, atëherë do të shkohet me veprime edhe më radikale, duke mos përjashtuar as grevën e përgjithshme në tërë sistemin arsimor që nga çerdhet, në Arsimin Parauniversitar dhe në Universitete.



Nga ky takim dhe nga konsultat e zhvilluara u mor vendimi që SBASHK të kërkojë nga Qeveria të ngritën pagat në mënyrë lineare në vlerën prej 100 euro për gjithë të punësuarit në arsim, shkencë e kulturë nga muaj prill e deri kur të nis së implementuari Ligji i ri i pagave, që duhet të jetë produkt i marrëveshjes paraprake mes Qeverisë dhe sindikatave.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Vazhdojnë edhe në muajin shkurt aktivitetet në shërbim të anëtarësisë **Mirënjohje dhe respekt meritë për SBASHK-un**


SBASHK edhe të shtunën e të dielën e 5 dhe 6 shkurtit ka vazhduar me trajnimet dhe aktivitetet tjera në shërbim të anëtarësisë. Kjo po arrihet falë përkushtimit të koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e stafit qendror dhe koordinimit me disa prej kryetarëve të nivelit komunal. Kështu në Malishevë pjesëmarrësit, pasi kanë përfunduar trajnimin për disa module të "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" janë takuar prapë për të dëshmuar njohuritë e arritura.



Këtë aktivitet e ka monitoruar koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Pjesë e këtij angazhimi ishte edhe kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Malishevën Skënder Gashi, i cili u ka uruar pjesëmarrësve sukses e pastaj ka falënderuar SBASHK-un për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë.



Po në vikendin e 5 dhe 6 shkurtit ka filluar edhe trajnimi "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" me trajneren Besa Hoxha Krasniqi. Në këtë trajnim që zhvillohet online pjesëmarrës janë koleget e kolegët tanë nga Mitrovica, Gjilani, Drenasi, Vitia, Prizreni, Klina, Lipjani, Fushë Kosova dhe Novobërda.



Në anën tjetër po në këtë vikend 35 kolege e kolegë nga komuna e Vitisë kanë nisur me trajnimin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" me trajnerin Musli Neziri. Në fillim të aktiviteti kryetari edhe kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunën e Vitisë Kemajl Bislimi ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe trajnerin për t'u dhënë pastaj sqarime lidhur me rrjedhën e këtij trajnimi.



Pjesëmarrësit kanë shprehur mirënjohje dhe respekt për angazhimin dhe përkushtimin e SBASHK-ut duke vlerësuar se me njohuritë e reja që do të marrin nga ky trajnim do të jenë edhe të suksesshëm në procesin edukativ e arsimor.



Vazhdojnë takimet e SBASHK-ut me MASHTI-n

Temë e bisedës Ligji i pagave dhe çështje të tjera

Përfaqësuesit e SBASHK-ut vazhdojnë me angazhimet me qëllim që kërkesat legjitime të anëtarësisë të gjejnë zgjidhje meritorë me dialog. Në shërbim të kësaj përpjekje ishte edhe takimi i radhës me zv/ministrin Dukagjin Pupovci, zyrtarin e lartë Hysni Kryeziu dhe këshilltarin Fatos Salihu.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka informuar përfaqësuesit e MASHTI-t se versioni që po qarkullon i Draft-ligjit të pagave ka krijuar pakënaqësi të gjithë sektori i arsimit dhe se në takimin e jashtëzakonshëm të Këshillit Drejtues dhe me

kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve janë dhënë vërejtje konkrete dhe është vendosur që njohësit e kësaj tematike të angazhohen dhe të përgatitin propozimin konkret e të argumentuar të SBASHK-ut dhe t'ia dërgojë institucioneve me shpresë se do të përfillen sepse në të kundërtën dot ketë veprime sindikale.

Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë sqarime të argumentuara lidhur me çështjet e ngritura duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me përfaqësues të MASHTI-t lidhur me Ligjin e pagave. Përfaqësuesit e MASHTI-it në këtë takim janë shprehur të gatshëm për të bashkëpunuar me SBASHK-un në mënyrë që të gjenden zgjidhje të mundshme e të pranueshme për çështjet e ngritura.

Marrëveshje me Ordinancën Stomatologjike ‘MORFODENT’

Shërbimet mjekësore 33 % më lirë për anëtarët e SBASHK-ut

Nga angazhimet e veçanta të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë është edhe nënshkrimi i marrëveshjeve me bizneset dhe institucionet shëndetësore e rekreative për zbritje të çmimeve për produktet dhe shërbimet. Këto zbritje vlejnë për anëtarët e SBASHK-ut, por në të shumtën e rasteve edhe për familjarët e tyre. Këto marrëveshje, numri i të cilave arrin në më shumë se 130, tregon respektin meritor ndaj punëtorëve të arsimit dhe ndaj SBASHK-ut që kanë menaxherët dhe stafi i shumë institucioneve shëndetësore, atyre të rekreacionit dhe bizneseve.

Një shembull i tillë e që gëzon respektin tonë është edhe ai i dr. spec. Flamur Vojvoda dhe Ordinancës Stomatologjike ‘MORFODENT’, që gjendet në rrugën ‘Kemal Atatürk’ në Mitrovicë. Në një ceremoni rasti marrëveshjen e kanë nënshkruar dr. spec. Flamur Vojvoda në emër të Ordinancës Stomatologjike ‘MORFODENT’ dhe Isa Ismajli në emër të Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Mitrovicës, gjegjësisht në emër të SBASHK-ut.



Kjo marrëveshje saktëson se të gjithë punëtorët e arsimit që janë anëtarë të SBASHK-ut, gjë të cilën do ta dëshmojnë me kartelën e anëtarësisë, do të gëzojnë zbritje prej 33% për të gjitha shërbimet mjekësore të kryera në këtë Ordinancë. Më tutje në këtë marrëveshje thuhet se kjo zbritje vlen edhe për familjarët e anëtarit të SBASHK-ut.

Situata me pandeminë ndryshoi mënyrën e shënimit të 7 Marsit


SBASHK aktivitetet i organizon në nivel të komunave dhe në Universitete

Ishte krijuar traditë e mirë e SBASHK-ut që në shenjë respekti për ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe të organizojë Manifestimin madhështor qendror në Pallatin e sporteve “1 Tetori” në Prishtinë duke bërë bashkë të pensionuarit nga marsi i vitit paraprak e deri në prillin e vitit vijues e duke dëshmuar respektin për ta me mirënjohje. Madhështia e këtij manifestimi shtohet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të institucioneve, të mysafirëve të nderuar nga trojet shqiptare dhe të Ansamblit Autokton “Rugova”.

Mirëpo kjo traditë është ndërprerë për momentin nga shkak i kufizimeve të bëra nga institucionet të diktuar nga pandemia. Por, SBASHK vazhdon të shënojë këtë datë të madhe dhe të lartësojë kujtimin për

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe stafi qendror ka përgëzuar kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Mitrovicës Isa Ismajli për këtë angazhim dhe falënderon e shpreh respekt meritore për dr. spec. Flamur Vojvoda dhe stafin e Ordinancës Stomatologjike “MORFODENT”.

pishtarët e dijes duke organizuar aktivitete festive në nivel të komunave dhe në Universitete.



Takim konsultativ i tri sindikatave

Angazhime për koordinim të aktivitetit dhe veprimeve



Në selinë e SBASHK-ut janë takuar përfaqësuesit e tri sindikatave që përfaqësojnë një pjesë të madhe të të punësuarve në sektorin publik. Përfaqësuesit e SBASHK-ut, të Sindikatës së Administratës Publike dhe ata të Sindikatës së Policisë kanë bashkëbiseduar

në këtë takim për situatën e krijuar pas qarkullimit të një versioni të Projektligjit të pagave. Ata kanë treguar për shqetësimet e anëtarësisë që përfaqësojnë duke përsëritur qëndrimet dhe vërejtjet lidhur me Projektligjin për paga.

Përfaqësuesit e të tri këtyre Sindikatave janë shprehur se në pritje të takimeve me Ministritë gjegjëse kanë ngritur grupe punuese duke përgatitur propozime konkrete e të argumentuara, të cilat do t'i prezantojnë.

Përfaqësuesit e këtyre tri sindikatave kanë shprehur pakënaqësi të shumta ndaj versionit të Projektligjit që është duke qarkulluar dhe janë pajtuar që në fillim të javës së ardhme BSPK-ja të organizojë tryezë tematike me pjesëmarrjen e të gjitha Sindikatave për të debatuar për situatën aktuale në të gjithë sektorët dhe për të koordinuar aktivitetet dhe veprimet sindikale.

Një vizitë e veçantë në selinë e SBASHK-ut

Anduena Krasniqi talente e lindur për pikturën

Enver Krasniqi, invalid i UÇK-së, bashkë me vajzën e tij Anduenën kanë vizituar selinë e SBASHK-ut dhe kanë bashkëbiseduar lirshëm me kryetarin Jasharaj për situatën në arsim dhe për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Kryetari Rrahman Jasharaj është shprehur se ndjehet i nderuar me këtë vizitë dhe se gjithë anëtarësia e SBASHK-ut ndjehet krenare me çdo sukses e arritje të nxënësve të Kosovës.

”Kosova ka një rini të shkëlqyer. Krenohemi kur

shohim se ka shumë talentë në muzikë, artin skenik, në pikturë e skulpturë sepse këta fëmijë nesër do të jenë emra të çmuar dhe do jenë krenaria e Kosovës”, është shprehur Jasharaj, i cili pastaj ka pranuar një dhuratë me vlerë nga nxënësja piktore Anduena Krasniqi. Një pamje e bukur e natyrës e punuar në pëlthurë është dëshmi e talentit të lindur dhe prirjes së natyrshme që Anduena ka për artin. Anduenës dhe gjithë nxënësve talentë të Kosovës u urojmë jetë të lumtur e plot arritje e suksese.

